



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 2016 prot.

Tiranë, më 12.04.2021

URDHËR

Nr. 84, datë 12.04.2021

"PËR
NGRITJENE GRUPIT TË MONITORIMIT TË SJËLLJES SË NËPUNËSVE
CIVILË NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË GJATË
PROCESIT ZGJEDHOR"

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të gurmës "c", të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, të neni 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 9, datë 26.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive enteve publike, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve",

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 452, datë 01.04.2021 "Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore", ka udhëzuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, dhe vijueshmërinë normale të punës, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor, gjatë veprimtarisë së tyre.

Për këto arsye,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Monitorimit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, me këtë përbërje:

- a) Znj. Vilma Kola, Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Kryetar;
- b) Znj. Alma Zili, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, Anëtar;
- c) Znj. Egrama Tafaj Specialist në Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore, Anëtar.

2. Koordinatorin e grupit të monitorimit, është znj. Alma Zili, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit, e cila komunikon me palët e interesuara në këtë proces, si dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

3. Grupi i Punës, deri në datën 12.04.2021, të hartojë rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregulla specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën e paraqet për miratim tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

4. Përcjelljen për njohje të këtij urdhri të gjithë nëpunësve civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe rregulloren “Për mbikëqyrjen e sjelljes nga grupi i monitorimit të nëpunësit civil në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, prill 2021”.

5. Ngarkohet Koordinatorin e Grupit të Monitorimit të informojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës 12.04.2021, për miratimin e këtij urdhri dhe rregullores së grupit të monitorimit.

6. Ngarkohet Grupi i Punës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani